

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Fall 11-2010

### Shtëpi Banimi

Enis Pakashtica

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Pakashtica, Enis, "Shtëpi Banimi" (2010). *Theses and Dissertations*. 1016.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1016>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



Nëntor, 2010



Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapsinorë

**Shtëpi Banimi**  
Niveli Bachelor

Enis Pakashtica

Nëntor / 2010  
Prishtinë



Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapsinorë

Niveli Bachelor  
Viti Akademik 2006 – 2009

Enis Pakashtica

**Shtëpi Banimi**

Mentori: Msc. Lulzim Beqiri ida

Nëntor 2010

Ky Punim Diplome është paraqitur në plotësimin e pjesshëm të kërkesave për nivelin Bachelor

## Përmbajtja

<b>MIRËNJOHJE .....</b>	<b><u>5</u></b>
<b>1. PËRSHKRIMI TEKNIK.....</b>	<b><u>6</u></b>
<b>1.1. Situacioni i Objektit .....</b>	<b><u>6</u></b>
<b>1.2. Arkitektura e Objektit .....</b>	<b><u>7</u></b>
<b>1.3. Përshkrimi i detajizuar .....</b>	<b><u>7</u></b>
<b>1.4. Konstruksioni, Instalimet dhe Materialet .....</b>	<b><u>9</u></b>
<b>1.5. Mbrojtja kundër zjarrit.....</b>	<b><u>11</u></b>
<b>2. SITUACIONI.....</b>	<b><u>12</u></b>
<b>3. BAZAT .....</b>	<b><u>13</u></b>
<b>3.1. Bodrumi.....</b>	<b><u>13</u></b>
<b>3.2. Përdhesa .....</b>	<b><u>14</u></b>
<b>3.3. Kati I .....</b>	<b><u>15</u></b>
<b>3.4. Nën Kulmi .....</b>	<b><u>16</u></b>
<b>3.5. Kulmi .....</b>	<b><u>17</u></b>
<b>4. PRERJET .....</b>	<b><u>18</u></b>
<b>6. Detali .....</b>	<b><u>19</u></b>
<b>7. Fasada .....</b>	<b><u>20</u></b>
<b>8. APPENDIXES.....</b>	<b><u>22</u></b>

## **MIRËNJOHJE**

E falenderoj shumë, dhe i jam shumë mirënjohës mentorit tim, Lulzim Beqirit, për inkurajimin, udhëzimin dhe mbështetjen që tregoj që nga fillimi e deri në fazën përfundimtare.

Gjithashtu, i falenderoj të gjithë ata të cilët më përkrahën në cdo aspekt gjatë punës në temën e diplomës.

Falenderimet më të thella, i takojnë familjes time të cilët më mbështetën gjithë jetën time, dhe se ky punim diplome kishte me qenë i pamundur pa ta.

## **PËRSHKRIMI TEKNIK**

- **Situacioni i Objektivit**

### Përshkrimi i Truallit Ekzistues

Shtëpi banimi në Prishtinë, është e parapare të ndertohet në parcelën në të cilën janë siguruar sipërfaqe të lira për organizimin e oborrit të shtëpisë, hapësirave të gjelbëra, parkingut, etj.

Trualli i paraparë për këtë objekt, gjendet në pjesën lindore të qytetit. Në lagjen Velania. Syprina e pronës që do të zhvillohet për destinim banimor, përfshinë 5.46 ari.

Në anën Veri-perindimore kufizohet me rrugën e lagjes me gjerësi prej 5.5m, ndërsa në të tre anët tjera kufizohet me troje që janë prona private.

Insolimi i truallit është i plotë, nuk ka pengesa dhe si i tillë mund konsiderohet si truall i shëndoshë për banim.

Në këtë mënyrë janë ofruar kushte të mira për zhvillimin e jetës si në brendi të objektit ashtu edhe jashtë tij.

Vet terreni i cili ka një ramje na ofron mundësi të mira për realizimin e objektit në fjalë. Objekti është përkaj rrugës kryesore dhe kyqja në situacion bëhet përmes kësaj rruge, që ka një pozitë mjaft atraktive.

- **Arkitektura e Objektivit**

### Arkitektura dhe Funkcioni

Objekti zhvillohet në keto kate:

- Bodrumi, ku është e vendosur pjesa teknike, garazha dhe një dhomë per rekreacion.
- Kati perdhëse, këtu gjenden Qendrimi Ditorë, Kuzhina, Dhoma e Ndhmëses, Dhoma Punes, dhe WC.
- Kati 1, gjenden Dhomë e Fjetjes për Prindër, 2 Dhoma Fjetje për Femijë, 2 Banjo, dhe 1 Dhoma Punë.
- Ndër-Kulmi, gjenden Studio, si dhe nje Dhomë per Hobi.

- **Përshkrimi i detajizuar**

Hyrja që është e organizuar në anën veriore dhe ka erëmbrojtësin që përcillet në dy dyer. Gjithashtu objekti përmban edhe hymjen ekonomike.

Holli me vazhdimin e tij qaset drejtëpërdrejtë me qëndrimin ditorë e cila komunikon ngusht me kuzhinën. Ky nivel është i shtrirë në kuotën 0.00. Përballë hyrjes ka të organizuar qëndrimin ditorë me kuzhinë, djathtas ka të organizuar një dhomë të punës, dhe shkallët për në etazhin e dytë. Ndërsa në anën e majtë ka të organizuar dhomen e ndihmëses (me banjo) dhe WC-në.

Kumunikimi vertikal është arritur përmes shkallëve të cilat janë të vendosura në qendër të objektit. Shkallet janë një-krahëshe, dhe jane të organizuara me mjaft funksionalitet.

Në bodrum janë të organizuara disa kthina për shfrytëzim të ndryshëm si dhoma për rekreacion, dhe kthinat për kaldatare, gjithashtu dhe kthinat tjera si depo e nevoja të ndryshme. Gjithashtu në bodrumë, gjindet garazha e cila ka aksesë nga niveli i rruges, me një ramje prej 14%.



Në katin e perdhesës janë të organizuara hapësirat për qëndrim ditorë. Niveli i perdhesës është 0.00, së bashku me pjesën e Qëndrimit Ditorë e cila poashtu gjindet në të njejtën kuotë.

Qëndrimi ditorë është i orientuar përballë hymjes kryesore gjë që e bënë më të thjeshtë orientimin e mysafirëve në shtëpi. Qëndrimi ditorë ka një hapësirë të mjaftueshme për organizim e cila e bën sa më të bukur dhe më luksoz. Qëndrimi Ditorë ka lidhje të drejtëpërdrejtë me terasë. Gjithashtu në qëndrimin ditorë është i ndarë edhe një kënd punë me organizim të tillë që mos ti pengoj funksionit të qëndrimit dhe pushimit në qëndrim ditorë.

Dhoma gjumit për ndihmësen percillet me korridorin që lidhë kuzhinën, banjon me degazhmanin. Dhoma e ndihmeses ka orientim lindorë dhe shtrihet ne pjesen lindore të objektit.

Hyrja në kuzhinë është përballë dhomës së ndihmëses. Kuzhina ka orientim të mirë dhe ndriqim natyror. Gjithashtu kuzhina është drejtëpërdrejtë e lidhur me trepezarinë e cila ka dalje në terasë. Gjithashtu kuzhina ka lidhje me deponë ushqimore. WC gjendet në të majtë të koridorit.

Në bodrum janë të organizuara 3 kthina për depo për shfrytëzim të ndryshëm, gjithashtu në bodrum është e organizuar edhe garazha.

Në katin e parë janë të organizuara, një dhomë gjumi për prindër me banjo dhe dy dhoma gjumi për fëmijë që shfrytëzojnë një banjo të përbashkët. Gjithashtu në këtë kat, gjendet edhe një dhomë punë. Dhomë e gjumite të prindërve dhe njera nga dhomat e gjumit të fëmijëve kanë dalje edhe në terasë.

Kulmi i shtëpisë është i rrafshët me një ramje të vogël prej 2%, i cili është i mbuluar me materiale te rreshqitshme si llamarina. Preferohet të jetë llamarinë e valëzuar kryesisht sandwich. Niveli i kulmit është +8.40 m.

Kulmi shfrytëzohet nga këto hapësira të destinuara për funksione të ndryshme të cilat janë, një dhomë për studio, dhe një dhomë për hobi.

Terrasa shtrihet në perimetër të këtyre kthinave dhe mundesi kyçje në terasë ka korridori. Siperfaqja më e madhe e terasës shtrihet në lindje dhe jug.

- **Konstruksioni, Instalimet dhe Materialet**

Konstruksioni është i koncipuar të ndërtohet në sistemin skeletor me themel pllakë të lidhura në mes veti me traje. Mbi traje të themeleve janë të vendosura drejtëpërsëdrejti muret, muret e jashtme nga beton armeja, kurse muret e mbrendshme nga bllokat.

Pllaka e themelit duhet të armohet në dy breza. Kjo pllakë nuk guxon të betonohet pa u vendosur të gjitha instalimet e nevojshme sikur që është kanali dhe gypat për nxemje qëndore, gypat e ujësjellësit dhe kanalizimit, si dhe kabllo të furnizuese të rrymës elektrike.

Punimi i hidroizolimit mbi pllakën e përdhësës të ngritet për 40 cm në mure nga ana e mbrendshme me kto shtresa:

Lyerja me EKOPRIMERA

BASEFLEX me atest (-10 - +100°C) ISO 9002

PRIMOFLEX me atest (-10 - +100°C) ISO 9002

Të gjitha diletimet horizontale dhe lidhjet e mureve, shtyllave, shkallëve me pllakë themele të jenë të izoluara me izolim 2 komponentësh.

Shtyllat dhe pllakat kryqë të konstruksionit meskatësh të betonohen me beton MB 30.

Pahia e pllakës duhet të jetë e lemuar. Betonimi i konstruksionit gjithashtu duhet të bëhet pas vendosjes së instalimeve të nevojshme.

Kulmi i rrafshet është i izoluar në mënyrë profesionale me materialet më bashkëkohore që i zgjedh investitori dhe organi mbikqyrës.

Rreth e rreth kulmit është e vendosur atika e kulmit me lartësi 80cm, e cila mbulohet me llamarinë.

Muratimi i mureve të jashtme është i paraparë të punohet me blloka giter 19x25x19cm, nga ana e jashtme termoizolimi t=8cm, rrjeta rabice si dhe fasada.

Muret ndarëse në mes të dhomave janë me blloka giter me dimensione 19x25x19cm.

Mirëpo ka edhe mure të cilat bëhen me blloka 15 cm, të cilat janë në pjesën ku vendosen dyert e banjove, meqë janë standarte trashësia e tyre.

Muret e sanitarieve punohen nga pllakat e gips kartonit të rezistushem nga uji, ose me blloka giter 15 cm, varësisht nga dëshira e investitorit. Trashësia e mureve ndarëse të sanitarieve perimetrike është 12 cm.

Mveshja e sanitarieve bëhet me pllaka të keramikës. Punimi i hidroizolimit tek sanitaritë është me izolim të ftohtë me keto shtresa:

Lyerja me EKOPRIMAR A,

Vendosja e shtreses se pare UUROFLEX

Vendosja e shtreses se POLIESTERIT

Lyerja e shtreses se dyte me EUROFLEX.

Hidroizolimi duhet te ngritet min. 40cm ne muret e sanitarieve.

Dyshemete:

Të gjitha dyshemetë duhet të jenë notuese dhe punohen në keto shtresa:

Izolimi akustik (URSA PIP/T t=4cm)

Estrihu 5cm i armuar me rrjete rabice  $\phi$ 6mm.

Ngjyra, dizajni dhe tekstura e dyshemesë të percaktohet nga projektuesi. Dyshemeja finale në hapsirat e dhomave është nga estrihu me trashësi 6-10mm, me këto shtresa:

Grundimi me StoPox GF ( material 2 komponentesh, poroz)

Shtruerja me StoQuarz ( me madhesi te granulatit 0.6-1.2mm)

Shtresa e reres se kuarcit me StoQuarz C 400 StoPox Ch 700

Mbyllja e poreve StoCryl PV 800 (mase ne baze ujore akrilitike, nje komponentesh)

Shtresa perfundimtare StoDiverts P 120 (mase per ipegrim, nje komponentesh) ose parket 2.5cm nga bungu

Ngjyra, dizajni, tekstura te zgjidhen nga projektanti.

Dyshemeja e keramikes kuotën më të ulët e kane per 2 cm, ne krahasim me kthinat tjera.

Livrimi dhe montimi i pllakave të keramikës të kualitetit të parë VILLEROY&BOCH ose te ngjajshëm në nyjet sanitarie (dysHEME dhe mure).

Keramika në dysHEME vendoset në përpjesë 1:4 ne ramje te projektuar sipas principit fugë në fugë.

Fuga e pllakave ARDEX ARDURIT FS DUSCHDICHT briljanteEib, ngjyra të përcaktohet nga projektanti.

Me ngjitës të pllakave ARDEX DIE ERFOLGFORMEN X7G, pllakat duhet të jenë pa shkëlqim. Pllakat e keramikës në mure vendosen me ngjitës në të njejtin princip dhe të njejtin prodhues por duhet të jenë me shkëlqim. Bashkimi i këndeve vertikale si ato të brendshme dhe ato të jashtme duhet të bëhen me profil special të plastikës. Në fund fugat mbushen me masë dhe pastrohen.

Elementet e zdrukthtarisë që e mbyllin objektin janë paraparë nga alumini ose plastika PVC. Preferohet që plastika PVC së paku të jetë me 5 hapësira, ngjyra përcaktohet nga investitori.

Elementet e brendshme gjegjësisht dyert me ngjyrë dispersive (ngjyra të përcaktuara nga projektanti), në dy shtresa të cilëve iu paraprinë faza e patenimit.

Fasada duhet të lyhet me shtrese mbrojtëse të tejdukshme pa shkëlqim për impegimin e tyre. Patinimi dhe bandazhimi i të gjitha sipërfaqeve të mureve të përpunuara me gips karton me pllaka KNAUF MP 75. Duhet të bëhet patinimi (suvatimi) i të gjitha sipërfaqeve të pllafoneve të rrafshta në dy shtresa. Suvatimi i xokulles së themeleve në pjesën e jashtme të bëhet me llaq të vazhduar.

- **Mbrojtja kundër zjarrit**

Sistemi i jashtëm i hidranteve dhe i brendshëm nëpër hyrje do të jetë sistemi primar i mbrojtjes kundër zjarrit.

Dyra e hyrjes do të jetë 30 min. e rezistueshme ndaj zjarrit.

Konstruksioni primar prej BA do të ketë trashësinë e duhur të betonit për mbrojtjen e armaturës së çelikut sipas eurokodit.